



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 134/9 prot.

Tiranë, më 14.07.2022

**VENDIM**  
**Nr. 98, datë 14.07.2022**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 54, DATË 15.04.2022.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 54, datë 15.04.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit të transferimit të përkohshëm, të nëpunëses \*\*\*\*\*”, nga pozicioni “Drejtore, në Drejtorinë e Financës”, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventarësh”, në Bashkinë Krujë”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 134 prot, datë 02.02.2022, paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, është marrë informacion për disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të transferimit, nga pozicioni i punës “Drejtore”, në Drejtorinë e Financës, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventarësh”, në Bashkinë Krujë, kryer me Urdhrin nr. 539, datë 26.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues nr. 54, datë 15.04.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit të transferimit të përkohshëm, të nëpunëses \*\*\*\*\*”, nga pozicioni “Drejtore, në Drejtorinë e Financës, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventarësh”, në Bashkinë Krujë.

Mbështetur në detyrat e vendosura në Vendimin nr. 54, datë 15.04.2022, njësia përgjegjëse në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procesit të transferimit të përkohshëm, duhej të kryente veprimet e parashikuara në pikën 1, të Vendimit Paralajmërues, si më poshtë:

*“Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Krujë, që të drejtojë procesin administrativ nëpërmjet të cilit, organi publik Kryetari i Bashkisë Krujë, të anulojë urdhrin nr. 576, datë 30.08.2019, “Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të urdhërojë kthimin e nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin e saj të mëparshëm të punës”.*

Pas përfundimit të afatit të caktuar në Vendimin e mësipërm, nëpunësja \*\*\*\*\* ka informuar elektronikisht Komisionerin në datën 17.05.2022, mbi mosveprimin e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë për përmbushjen e detyrimeve brenda afatit të caktuar në Vendimin nr. 54, datë 15.04.2022, të Komisionerit, duke i bashkëlidhur njëkohësisht shkresën nr. 2269 prot, datë 19.04.2022, të Bashkisë Krujë/Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me lëndë *“Njoftim paraprak për lirim nga detyra e nxjerrje në pension pleqërie”*, drejtuar nëpunëses \*\*\*\*\*.

Në funksion të zbatimit të Vendimit Paralajmërues, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 134/6 prot, datë 18.05.2022, ka kërkuar nga Bashkia Krujë të parashtrijë arsyet e mosrespektimit të afatit të vendosur në Vendimin nr. 54, datë 15.04.2022, dhe njëkohësisht të dërgohet informacion në lidhje me masat konkrete që janë marrë për zbatimin e tij.

Bashkia Krujë me shkresën nr. 3072/1 prot, datë 31.05.2022, administruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 134/7 prot, datë 02.06.2022, ka informuar se referuar VKM nr. 478, datë 16.06.2000, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”*, \*\*\*\*\* , më datë 02.07.2022, plotëson moshën për dalje në pension pleqërie.

Në kushtet kur tashmë ky kusht është përmbushur, pra ka kaluar afati i plotësimit të moshës për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë, referuar nenit 95, të ligjit Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, për shkak të pamundësisë në objekt apo qëllim, mendojmë se nuk ka më vend për të vijuar ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të caktuara në Vendimin nr. 54, datë 15.04.2022, të Komisionerit.

Pavarësisht sa më sipër, çmujmë se duhet theksuar fakti se nga ana e Bashkisë Krujë nuk janë zbatuar detyrat e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit. Mosveprimi nga ana e këtij subjekti, mund të ketë sjellë cenimin e interesave të ligjshme të nëpunëses në raport me masën e pensionit, e cila duhej të kishte dalë në pension në pozicionin *“Drejtor”*.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 54, datë 15.04.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit të transferimit të përkohshëm, të nëpunëses \*\*\*\*\*”, nga pozicioni “Drejtor, në Drejtorinë e Financës”, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventarësh”, në Bashkinë Krujë”.
2. Konstatimin e pamundësisë në objekt apo qëllim për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të Vendimit Nr. 54, datë 15.04.2022.
3. Bashkia Krujë dhe njësia përgjegjëse e këtij institucioni, të tregojnë kujdes që në të ardhmen të zbatojnë me përpikëri ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për shërbimin civil, si dhe detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimet paralajmëruese.
4. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Krujë dhe punonjësja \*\*\*\*\*.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**